



# FLETORJA ZYRTARE

## E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

**Nr.74**

**2005**

**14 tetor**

### P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.602, datë 3.10.2005	Për sistemimin me mjedise të Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe të Ministrisë së Integritimit...	2487
Vendim i KM nr.608, datë 3.10.2005	Për lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, për marrjen e masave emergjente për parandalimin e përmytjeve në zonën e Lezhës, si dhe për shtyrjen e afatit të prokurimit të disa fondeve buxhetore.....	2487
Vendim i GJL nr.1, datë 24.3.2005	Me objekt anulimin e pjesëshëm të vendimit të KKK Pronave nr.13, datë 29.10.1993, anulim i kontratës së dhurimit.....	2488
Vendim i ERE nr.53, datë 26.9.2005	Për afatin e shqyrtimit të aplikimeve për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike, nga të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga centralët e vegjël.....	2497
Vendim i KKRT nr.359, datë 26.9.2005	Për dhënie licence për televizionin kabllor privat “Kl-Ed”.....	2497
Vendim i KKRT nr.360, datë 26.9.2005	Për dhënie licence për ritransmetim të programeve të huaja radio në Shqipërisë “World Family” .....	2498
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Josif Karaj.....	2498

**VENDIM**  
**Nr. 602, datë 3.10.2005**

**PËR SISTEMIMIN ME MJEDISE TË MINISTRISË SË PUNËVE PUBLIKE,  
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT, TË MINISTRISË SË TURIZMIT,  
KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE DHE TË MINISTRISË SË INTEGRIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Godina e ish-Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit t’i kalojë në administrim dhe përdorim Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.
2. Godina e ish-Ministrisë së Transportit dhe të Telekomunikacionit t’i kalojë në administrim dhe përdorim Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
3. Godina e ish-Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve t’i kalojë në administrim dhe përdorim Ministrisë së Integrimit.
4. Pika 1 e vendimit nr.339, datë 1.6.2004 të Këshillit të Ministrave “Për sistemimin me mjedise pune të disa institucioneve shtetërore dhe për një ndryshim në vendimin nr.515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes””, shfuqizohet.
5. Ngarkohen Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministri i Integrimit dhe Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr. 608, datë 3.10.2005**

**PËR LEJIMIN E MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË  
KONSUMATORIT TË PËRDORË PROCEDURËN “PROKURIM I DREJTPËRDREJTË”,  
PËR MARRJEN E MASAVE EMERGJENTE PËR PARANDALIMIN E PËRMBYTJEVE NË  
ZONËN E LEZHËS, SI DHE PËR SHTYRJEN E AFATIT TË PROKURIMIT TË DISA  
FONDEVE BUXHETORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7 e 14 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, dhe të neneve 5 e 17, pika 3 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, që, për fondin prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh, të përdorë procedurën “Prokurim i drejtpërdrejtë”, me Bordin e Kullimit, Lezhë, për marrjen e masave emergjente për parandalimin e përmbytjeve në zonën e Lezhës.

2. Fondi prej 13 000 000 (trembëdhjetë milionë) lekësh, i cili shtohet në programin “Infrastruktura e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet”, të përballohet nga fondet për investime, miratuar në buxhetin e vitit 2005, për Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, i ndarë:

a) 6 500 000 (gjashtë milionë e pesëqind mijë) lekë, nga programi “Shërbime të Inspektoratit të Bujqësisë, Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes Konsumatore”;

b) 2 000 000 (dy milionë) lekë, nga programi “Mbështetja e prodhimit bujqësor, blegtoral, agroindustria dhe marketingu”;

c) 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë, nga programi “Kërkimi dhe ekstensioni”.

3. Afati i prokurimit të fondeve për investime, me vlerë 2 000 000 (dy milionë) lekë, parashikuar në programin “Mbështetja e prodhimit bujqësor, blegtoral, agroindustria dhe marketingu”, për hartimin e projekteve të thertoreve dhe tregjeve me shumicë, që do të ndërtohen gjatë vitit 2006 nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, të shtyhet deri në fund të muajit nëntor të vitit 2005, duke përfshirë në këtë afat edhe lidhjen e kontratës.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Ribotim për arsye gabimesh teknike i vendimit të Gjykatës së Lartë  
nr.1, datë 24.3.2005 botuar në Fletoren Zyrtare nr.70

**VENDIM**  
**Nr. 1, datë 24.3.2005**

**NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë të përbërë nga:

Thimjo Kondi	Kryetar
Zamir Poda	Anëtar
Kristaq Ngjela	Anëtar
Spiro Spiro	Anëtar
Vladimir Bineri	Anëtar
Artan Hoxha	Anëtar
Vladimir Metani	Anëtar
Shpresa Beçaj	Anëtare
Irma Bala	Anëtare
Besnik Imeraj	Anëtar
Nikoleta Kita	Anëtare
Agron Lamaj	Anëtar
Ylvi Myrtja	Anëtar
Adrian Dvorani	Anëtar
Perikli Zaharia	Anëtar
Evjeni Sinoimeri	Anëtare

në seancën gjyqësore të datës 24.3.2005, shqyrtuan çështjen civile me palë:

PADITËS: Virgjin Llakmani, Kristaq Llakmani, Ermira Llakmani  
TË PADITUR: Ollga Çomo, Dhimitraq Çomo, përfaqësuar nga avokat Fatmir Braka e Flora Gjini.

Komisioni i Kthimit e Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve pranë bashkisë Pogradec.

OBJEKTI: *Anulim i pjesshëm i vendimit të KKK Pronave nr.13, datë 29.10.1993, anulim i kontratës së dhurimit.*

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë**, me vendimin nr.1802, datë 17.11.2000, ka vendosur rrëzimin e padisë.

**Gjykata e Apelit Korçë**, me vendimin nr.349, datë 15.11.2002, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Kundër vendimeve të mësipërme kanë ushtruar rekurs paditësit që kërkojnë ndryshimin e tyre dhe pranimin e padisë duke parashtruar:

Vendimet janë rrjedhojë e proceseve të parregullta ligjore, pasi nuk është zhvilluar drejt debati gjyqësor.

Në vendimet e gjykatave nuk gjejnë vend pretendimet tona dhe nuk arsyetohet përse nuk merren parasysh duke mos bërë analizën e plotë të provave dhe ballafaqimit të tyre me kërkesat ligjore.

Të dy vendimet janë rezultat i zbatimit të gabuar të ligjit për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve dhe akteve nënligjore dalë për zbatimin e tij.

Banesa është marrë nga shteti në kohën që e kishte në pronësi trashëgimlënësi Gjokë Vako duke i dhënë në këmbim të saj një ndërtesë njëkatëshe me dy dhoma të mëdha, dy të vogla e bodrume, ish-pronë e familjes Erebara. Akti i Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Pogradec që ka miratuar këmbimin nuk përben akt shpronësimi.

I padituri, KKK Pronave, në mënyrë të kundërligjshme ia ka kthyer banesën e përbërë nga 16 dhoma e anekset përkatëse së paditurës Ollga Çomo, duke njohur vetëm atë pronare dhe jo trashëgimtarët ligjorë të njohur me dëshminë e kërkuar nga vetë e paditura.

Kontrata e dhurimit, lidhur midis të paditurve, është e pavlefshme, pasi na mohon bashkëpronësinë.

**Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë**, me vendimin e datës 11.05.2004, ka kaluar çështjen për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara për të unifikuar lidhur me përcaktimin e sendeve të trashëgueshme dhe pasojat që sjell te trashëgimtarët ndryshimi i gjendjes së sendeve të lëna në trashëgimi.

#### KOLEGJET E BASHKUARA TË GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjuan relacionin e gjyqtarëve Kristaq Ngjela dhe Artan Hoxha, përfaqësuesit e të paditurve, avokatët Fatmir Braka e Flora Gjini, që kërkuan lënien në fuqi të vendimeve, dhe pasi analizuan çështjen në tërësi,

#### VËREJNË:

Me vendimin nr.13, datë 29.10.1993, Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ish Pronarëve pranë bashkisë Pogradec ka njohur pronare Ollga Çomon (Vako) për një ndërtesë dy katëshe, me oborr, me 16 dhoma, dy korridore, dy banja, që ndodhet në lagjen nr.1, rruga "Reshit Çollaku" në qytetin e Pogradecit me një sipërfaqe prej 312,60 m<sup>2</sup> dhe kufizimet përkatëse. Në bazë të nenit 13/2 të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, Ollga Çomo është detyruar të paguajë shumën prej 51 719 lekësh që përbën vlerën e shtesave të bëra nga shteti në atë ndërtesë, pas pagimit të së cilës banesa i kalon në pronësi.

Vendimin e mësipërm, marrë mbi kërkesën e të paditurës Ollga Çomo, KKK Pronave e ka bazuar mbi një testament që ka bërë trashëgimlënësi (babai i saj) Gjokë Vako sipas të cilit, pas vdekjes, Ollga Çomos i lë në pronësi banesën njëkatëshe, me dy dhoma të mëdha, dy të vogla dhe oborr.

Ashtu sikurse pranohet nga gjykatat, rezulton se Gjokë Vako, ka pasur në pronësi një shtëpi dykatëshe me 16 dhoma, oborr e anekset përkatëse. Me propozim të seksionit të shëndetësisë, Komiteti Ekzekutiv i KP të rrethit Pogradec ka marrë vendimin nr.14, datë 22.2.1952 për shkëmbimin pa shpërblim, me vullnetin e pronarit Gjokë Vako, të kësaj banese me një tjetër që shërbente si maternitet, duke përcaktuar edhe përbërjen e dy ndërtesave dhe kufizimet e tyre. Pas kësaj, Gjokë Vako e familja, kanë pasur në pronësi e përdorur për banim, banesën njëkatëshe të shkëmbyer.

Në datën 23.11.1972, Gjokë Vako ka bërë para noterit një testament në të cilin shprehet se *“Në shenjë mirënjohje, respekti e dashurie ndaj vajzës Ollga Gjokë Tira, për afekcionin e interesimin e vazhdueshëm që ka treguar, me vullnetin e lirë e të plotë, pas vdekjes, i lë në pronësi një shtëpi banimi që e kam në pronësi e posedim të ndodhur në lagjen nr.3 Pogradec në rrugën "Reshit Çollaku", me kufizime: lindje Niko Ballkameni, jug Kolë Maxhari, veri liqeni dhe rruga publike, e përbërë nga një kat, me bodrume poshtë, me dy dhoma të mëdha e dy të vogla dhe me oborr para e mbrapa, me kusht që në të të banojë djali i saj, nipi im i quajtur Koço Tira”. Në vazhdim në testament disponohet se “me rastin e bërjes së këtij testamenti, unë përjashtoj si trashëgimtarë time ligjore mbi këtë shtëpi vajzën time, Vika Gjokë Llakmani”.*

E paditura Ollga Çomo, ka kërkuar të lëshohet dëshmi, trashëgimisë dhe me aktin noterial nr.51, datë 29.6.1993, në të cilin përshkruhet se trashëgimlënësi Gjokë Vako ka vdekur në vitin 1974, se ai ka disponuar me testament për t'i lënë në pronësi vajzës së tij Ollga Çomo një shtëpi njëkatëshe, është vendosur që të njihen si trashëgimtarë ligjorë për çdo lloj pasurie të trashëgimlënësit Vangjel Vako, trashëgimtarë Ollga Çomo, Ermira, Virgjil, Kristaq, Roza e Vasil Llakmani, duke përcaktuar edhe pjesët e tyre.

Në datën 9.9.1999, paditësit Kristaq, Virgjil dhe Ermira Llakmani, me cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të trashëgimlënësit Gjokë Vako, kanë ngritur padi kundër KKK Pronave dhe personit të tretë Ollga Çomo, duke kërkuar ndryshimin e vendimit të KKK Pronave, deklarimin e pavlefshëm të kontratës së dhurimit lidhur midis të paditurve Ollga Çomo e Dhimitraq Çomo, njohjen si bashkëpronarë në banesën e kthyer Ollga Çomos dhe pjesëtimin e pasurisë që përbëhej nga shtëpia me 16 dhoma e anekse, me pretendimin se me testamentin e Gjokë Vacos, së paditurës Ollga nuk i ishte lënë në pronësi ajo shtëpi, por shtëpia njëkatëshe me dy dhoma, që efektivisht ishte në pronësi në kohën e bërjes së testamentit.

Gjykata e Rrethit gjyqësor Korçë ka rrëzuar kërkesëpadinë e paditësve me arsyetimin se trashëgimlënësi Gjokë Vako, me testamentin e datës 23.11.1972, ka disponuar në favor të Ollga Çomos shtëpinë e banimit që iu dha në shkëmbim të shtëpisë objekt gjykimi, se banesa e lënë në testament ka qenë pronë e ish-pronarit Ali Erebara që i ishte shpronësuar në vitin 1950. Paditësit pretendojnë se Gjokë Vako i ka lënë në pronësi me testament vajzës së tij, së paditurës Ollga Çomo, një banesë të individualizuar dhe në këto kushte, për banesën objekt gjykimi duhet të zbatohet trashëgimia ligjore. Por, vazhdon arsyetimin gjykata, ish-pronarit Gjokë Vako i njihet pronësia mbi banesën objekt gjykimi dhe ka vend që vullneti i testatorit, t'i shtrijë efektet mbi këtë banesë, pasi trashëgimia me ligj ka vend kur trashëgimlënësi nuk e ka disponuar me testament pasurinë dhe për pasojë dhe kontrata e dhurimit është e ligjshme e nuk ka vend të anulohet pasi e paditura Ollga, duke qenë pronare e vetme e banesës, ka disponuar me vullnetin e saj të lirë në favor të djalit të saj.

Gjykata e Apelit Korçë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit duke pranuar faktet si më sipër se e paditura Ollga Çomo kishte banuar realisht në shtëpinë e lënë me testament në pronësi të saj derisa me vendim të KKK Pronave, iu kthye ish-pronarit Ali Erebara, se në zbatim të ligjit, shteti nëpërmjet KKK Pronave, ka ndërhyrë duke prishur në mënyrë të njëanshme kontratën e shkëmbimit, me qëllim që të rregullonte një padrejtësi që i ishte bërë ish-pronarit Ali Erebara dhe se me zgjidhjen e kësaj kontrate shkëmbimi, KKK Pronave ka rivendosur në gjendjen e mëparshme trashëgimtarë testamentare, të paditurën Ollga Çomo duke i kthyer asaj në pronësi shtëpinë e të atit. Gjykata e Apelit arsyeton se trashëgimlënësi me testament ka shprehur vullnetin e tij duke kaluar pronësinë në favor të Ollgës dhe se nuk ka bazë për trashëgimi ligjore, kur vullneti i tij ka qenë i qartë, të përjashtojë nga trashëgimia vajzën tjetër, Vika Llakmani.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë i gjejnë të pabazuara vendimet e gjykatave, konstatojnë zbatim të gabuar të ligjit, ndaj çmojnë se është i nevojshëm unifikimi i praktikës gjyqësore, lidhur me problemet e mëposhtme:

1. *A mund të shtrihet cilësia e trashëgimtarit testamentar edhe mbi sende (të drejta), të cilat nuk bënin pjesë në pasurinë e de cuius në momentin e hartimit të testamentit, por që ekzistojnë në aktivin e kësaj pasurie në momentin e çeljes së trashëgimisë.*

2. *Në formën e trashëgimisë testamentare, kur caktimi i sendeve (të drejtave) është bërë nga vetë testatori, ekzistenca e sendeve si edhe vlera e tyre, do t'i referohet momentit të hartimit të testamentit, apo vdekjes së testatorit.*

1. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë konstatojnë se Gjykata e Shkallës së Parë Korçë ka rrëzuar padinë duke arsyetuar në mënyrë të gabuar se vullneti i testatorit i shtrin efektet mbi banesën objekt gjykimi, pasi trashëgimia me ligj ka vend kur trashëgimlënësi nuk e ka disponuar me testament pasurinë e tij.

Gjykata *ab initio* nisat nga një argument tërësisht i gabuar, ai i përjashtimit të ekzistencës njëheraz të dy formave të trashëgimisë, asaj ligjore dhe asaj testamentare. Sipas dispozitave të legjislationit civil në fuqi në momentin e çeljes së trashëgimisë, por edhe atij aktual, këto dy forma të trashëgimisë nuk e përjashtojnë njëra-tjetrën, por, krejt ndryshe, trashëgimia testamentare mund të bashkekzistojë me trashëgiminë ligjore, kur testamenti është bërë vetëm për një pjesë të pasurisë apo kur testamenti është i pavlefshëm (neni 1 i dekretit “Mbi trashëgiminë” nr.1892, datë 5.7.1954 dhe neni 317 i Kodit Civil të sotëm).

Po ashtu ekzistenca e një trashëgimtarit që gëzon të drejtën e rezervës ligjore, imponon në mënyrë të detyrueshme bashkekzistencën e trashëgimisë testamentare me trashëgiminë ligjore (neni 33 i dekretit dhe neni 379 i Kodit Civil).

Gjykata, pa përcaktuar llojin e testamentit, arsyeton se vullneti i testamentlënësit mund t'i shtrijë efektet edhe mbi sende të cilat janë fituar nga testatori pas hartimit të testamentit. Duke qenë se në çështjen në gjykim, sendi i përcaktuar në testament nuk ekziston e ndërkohë, në pasurinë e *de cuius* shfaqet një tjetër send i paluajtshëm, problemi juridik që shtrohet për zgjidhje përpara gjykatës ishte interpretimi i dispozitave testamentare, nga i cili do të rezultonte përcaktimi i karakterit universal apo me titull të posaçëm i këtij testamenti. Vetëm cilësia e trashëgimtarit universal do të mund t'i japë të drejtën trashëgimtares së përcaktuar në testament të përfitojë nga e gjithë pasuria e testamentlënësit, ashtu siç gjendet ajo në momentin e çeljes së trashëgimisë. Përcaktimi i karakterit të testamentit lidhet ngushtësisht me thirrjen *vocazione* që trashëgimlënësi përcakton nëpërmjet testamentit, dhe jo me sasinë e sendeve që përfitohen efektivisht.

Individualizimi i sendit në testament duhet ta çonte gjykatën në përfundimin që përfituesja e sendit të paluajtshëm është trashëgimtare me titull të posaçëm. Fakti që testatori nuk ka veçse një send të paluajtshëm në momentin e hartimit të testamentit, nuk mund të çojë në konkluzionin e gabuar që thirrja, që i bëhet trashëgimtares testamentare, është mbi të gjithë pasurinë.

Gjykata e Apelit Korçë ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së rrethit, duke pranuar arsyetimin e saj dhe duke e përforcuar nëpërmjet interpretimit të dispozitave të testamentit përse i përket përjashtimit nga pasuria trashëgimore të vajzës tjetër të testamentlënësit. Në fakt, caktimi i një trashëgimtarit universal mbi të gjithë pasurinë trashëgimore, do të çonte në interpretimin që testatori ka përjashtuar në mënyrë indirekte nga trashëgimia, trashëgimtarë të tij të tjerë ligjorë, jorezervatarë. Ndërkohë, nga testamenti rezulton se jo vetëm që ai limitohet në një send individualisht të përcaktuar, por edhe përjashtimi i njëres prej trashëgimtarëve ligjore, ka vend pikërisht për sendin në fjalë, e jo për pasurinë e trashëgimlënësit në tërësi, ashtu sikurse në mënyrë të gabuara interpreton Gjykata e Apelit.

Në rekursin e paraqitur nga pala paditëse, pretendohet me të drejtë se në vendimet e gjykatave nuk gjejnë vend pretendimet e tyre dhe nuk arsyetohet përse nuk merren ato parasysh.

Gjykata e Lartë është e mendimit se në çështjen në gjykim, cilësinë e trashëgimtarëve me titull universal e kanë trashëgimtarët ligjorë të testatorit dhe jo trashëgimtarja e përcaktuar në testament, e cila rezulton të jetë trashëgimtare me titull të posaçëm, përfituese vetëm e sendit të përcaktuar në testament. Për rrjedhojë, ajo nuk mund të përfitojë nga shtimi i pasurisë së *de cuius* pas datës së hartimit të testamentit.

Për të arritur në këtë përfundim, Gjykata e Lartë ka parasysh se, që testamenti të jetë universal apo me titull universal është absolutisht e nevojshme të demonstrohet që testatori kur ka disponuar sendin, ka pasur parasysh të gjithë pasurinë e tij, pra tërësinë e të drejtave në momentin e vdekjes së tij, dhe jo një përfitim konkret mbi trashëgiminë, sikurse rezulton nga interpretimi i testamentit në këtë gjykim.

Në funksion të burimit të trashëgimisë në pasurinë trashëgimore, marrëdhënia e trashëgimisë do të jetë ligjore, nëse ajo përcaktohet nga ligji dhe testamentare nëse përcaktohet nga veprimi juridik i njëanshëm, i cili në terminologjinë e ligjit njihet me emrin testament.

Duke u nisur nga një tjetër kriter, ai i objektit të pasurisë trashëgimore, marrëdhënia e trashëgimisë mund të jetë trashëgimi universale; trashëgimi me titull universal; trashëgimi me titull të posaçëm.

Terminologjinë e këtij klasifikimi të marrëdhënies juridike të trashëgimisë e gjejmë kryesisht në doktrinën juridike, por që ka ardhur si reflektim i dispozitave të legjislacionit civil në funksion të shtrirjes se të drejtave mbi pasurinë trashëgimore. Kështu në nenin 6 të dekretit për trashëgiminë dhe në neni 332 të Kodit Civil përcaktohet njësoj se “*Trashëgimtari mund të fitojë të gjithë pasurinë e trashëgimlënësit ose një pjesë të saj, ose vetëm një send të caktuar, ose një të drejtë tjetër pasurore*”. Ndërsa në neni 692 të Kodit Civil ligjvënësi përdor termin në mënyrë të shprehur kur përcakton se “*Efektet juridike të kontratës shtrihen edhe tek trashëgimtarët me titull universal...*”.

Duke iu referuar arsytimit të mësipërm si dhe doktrinës, Kolegjet arrijnë në përfundimin se në trashëgiminë universale dhe atë me titull universal, shtrirja e së drejtës së trashëgimisë i referohet një situatë pasurore gjenerike, të papërcaktuar të subjektit që do të përfitojë, duke e vënë atë në kushtet e një vazhdimësie (suksedimi) mbi të gjitha marrëdhëniet që do të transferohen në çastin e çeljes së trashëgimisë, me përjashtim të atyre që janë të lidhura ngushtë me trashëgimlënësin (si e drejta për ushqim) apo që përcaktohen ndryshe nga testamenti.

Nga ana tjetër, dallimi ndërmjet trashëgimisë universale dhe asaj me titull universal është vetëm sasior.

Në trashëgiminë universale, thirrja në trashëgimi, e përcaktuar nga ligji apo testamenti, i referohet të gjithë pasurisë së *de cuius*. Kjo situatë do të ndeshet në ato raste kur ka vetëm një trashëgimtar ligjor, apo kur testatori përcakton në testament që e gjithë pasuria e tij i kalon vetëm një personi.

Ndërsa në trashëgiminë me titull universal, thirrja në trashëgimi nuk i referohet të gjithë pasurisë së lënë, por një pjesë të saj, e cila shprehet në formën e një fraksioni aritmetik ose përcaktimit të kuotave (1/2; 1/4).

Nga ana tjetër, në trashëgiminë me titull të posaçëm, thirrja në trashëgimi i referohet një ose disa sendeve apo të drejtave të përcaktuara nga trashëgimlënësi, duke caktuar gjithashtu personin që do të ketë përfitimin pasuror.

Në dallim nga trashëgimia ligjore, e cila nuk mund të jetë veçse universale apo me titull universal, pasi thirrja bëhet mbi të gjithë trashëgiminë apo mbi një fraksion aritmetik të saj, në rastin e trashëgimisë testamentare, duke qenë se burimi i thirrjes në trashëgimi *vocazione* është vullneti i vetë trashëgimlënësit, shtrirja mbi të drejtat trashëgimore ka të bëjë ekskluzivisht me marrëdhënie të përcaktuara nga trashëgimlënësi, i cili nëpërmjet një veprimi juridik të njëanshëm, testamentit, formulon vullnetin e tij. Për rrjedhojë, thirrja në trashëgimi në rastin e trashëgimisë testamentare mund të jetë jo vetëm mbi të gjithë pasurinë trashëgimore apo një pjesë të saj - me titull universal - por edhe mbi një ose disa sende të veçanta - me titull të posaçëm.

Mbështetur në sa u arsyetua më sipër, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se:

Vetëm trashëgimtarët universalë apo me titull universal kanë zotësi juridike për të përfituar edhe elemente pasurore, të cilat *de cuius* nuk i ka parashikuar shprehimisht në testament. Vetëm ata përfitojnë të drejta (sende) që janë fituar pas hartimit të testamentit e që ekzistojnë në pasurinë e trashëgimtarit në momentin e çeljes së trashëgimisë dhe nga ana tjetër kanë gjithashtu detyrimin të përmbushin *intra vires hereditatis* -në kufijtë e pasurisë trashëgimore- detyrimet që rëndojnë mbi këtë pasuri.

Sa më sipër, të sjell në konkluzionin logjik se vetëm në rastin e trashëgimisë universale apo asaj me titull universal, përfshihen edhe ato marrëdhënie juridike, ekzistenca e të cilave nuk njihet nga vetë testamentlënësi.

Në të kundërt, trashëgimtari me titull të posaçëm (legatari) ka një të drejtë të kufizuar, që lidhet me sendet apo të drejtat e përcaktuara shprehimisht në testament - *ut singuli*- e për rrjedhojë, ndryshimet e pasurisë trashëgimore të konstatuara në momentin e çeljes së trashëgimisë, nuk do të reflektohen në titullin e tyre.

2. Në çështjen në gjykim, rezulton se objekt i testamentit, banesa njëkatëshe e ndodhur në lagjen nr.3, rr."Rreshit Çollaku", Pogradec, i është kthyer nga KKK të Pronave ish-pronarit Ali Erebara, të cilit i ishte shpronësuar nga shteti në vitin 1950. Ndërsa me vendimin nr.13, datë 29.10.1993, i njëjti organ i kthen trashëgimtarit të Gjokë Vako një tjetër ndërtesë dykatëshe, të cilën e ka pasur në pronësi deri në vitin 1952, datë në të cilën lidh një kontratë shkëmbimi, me vendim të organit kompetent të asaj kohe.

Me fjalë të tjera, rezulton se KKK Pronave ka zgjidhur në mënyrë të njëanshme kontratën e shkëmbimit të lidhur në vitin 1952 ndërmjet Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit Pogradec dhe Gjokë Vakos, e si rrjedhojë e kësaj zgjidhjeje palët kthehen në gjendjen e mëparshme - *restitutio in integrum*-, duke i rikthyer njëra-tjetrës sendet respektive, objekte materiale të kontratës së shkëmbimit.

Për të arritur në përfundimet e mëtejshme, Kolegjet kanë parasysh edhe faktin se formojnë objekt testamenti çdo send i luajtshëm apo i paluajtshëm, individualisht i përcaktuar (në lloj) ose i përcaktuar në mënyrë gjenerike (në gjini), që ekziston në momentin e hartimit të testamentit apo që do të ekzistojë në të ardhmen, duke përfshirë edhe të drejta të tjera reale ose detyrimi.

Në kushtet e krijuara, kur ndërtesa njëkatëshe, objekt i testamentit me titull të posaçëm të hartuar në vitin 1972, iu kthye ish-pronarit dhe jo testamentlënësit, i çon Kolegjet e Bashkuara në përfundimin se testamenti ka mbetur pa objekt, e për rrjedhojë disponimi i testatorit nuk mund të sjellë pasoja juridike në favor të përfituesit të këtij testamenti. Testamenti me objekt një send individualisht i përcaktuar, në rast se sendi nuk gjendet në pasurinë trashëgimore apo mbi të cilën një tjetër subjekt ka titull pronësie, do të jetë i pavlefshëm, pa bërë dallim nëse trashëgimtarësi kishte apo jo dijeni rreth ekzistencës së titullit të pronësisë.

Marrë për bazë sa u arsyetua më sipër, Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë arrijnë në përfundimin unifikues se:

**Trashëgimtari testamentar do t'u nënshtrohet të gjitha ndyshimeve që ka pësuar pasuria e trashëgimtarit, nga data e përpilimit të testamentit deri në momentin e çeljes së trashëgimisë, pasi testamenti është një veprim juridik *mortis causa* -për shkak të vdekjes-dhe në dallim nga veprimet juridike *inter vivos*-ndërmjet të gjallëve-i sjell efektet vetëm nga momenti i vdekjes së testatorit.**

Për të vlerësuar ekzistencën e titullit mbi një send të caktuar, të cilin testamentlënësi e ka disponuar nëpërmjet testamentit, do të merret në konsideratë data e vdekjes së *de cuius* - data e çeljes së trashëgimisë- dhe jo data e hartimit të testamentit.

Ashtu si përcaktimi i përfituesit të testamentit, edhe ekzistenca e sendeve të disponuara nëpërmjet tij, si edhe vlera e tyre do të raportohen në momentin e çeljes së trashëgimisë dhe jo në datën e hartimit të testamentit.

Është e kuptueshme që thirrja në trashëgiminë testamentare do të realizohet nëse sendet e përcaktuara nga testatori do të gjenden në pasurinë e tij në momentin e çeljes së trashëgimisë.

**Mosekzistenca e tyre materiale-amortizimi ose shembja-apo juridike-tjetërsimi i tyre-do t'i bënte të pavlefshme dispozitat testamentare që disponojnë këto sende apo të drejta.**

Gjithashtu, nëpërmjet këtij gjykimi, paditësit kanë kërkuar edhe konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit nr.596 rep e nr.315 kol,datë 6.9.1994 lidhur ndërmjet të paditurve Ollga Çomo e Dhimitraq Çomo.

Si rezultat i vendimit nr.13, datë 29.10.1993 të Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave pranë bashkisë Pogradec, i cili i njeh të drejtën e pronësisë mbi ndërtesën dykatëshe paditëses Ollga Çomo, duke ushtruar tagrin e disponimit, ajo ka lidhur një kontratë dhurimi me të paditurin Dhimitraq Çomo, me objekt kalimin e pronësisë së 7 dhomave të kësaj ndërtese në favor të këtij të fundit.

Duke pretenduar ndryshimin e vendimit të KKK të Pronave për njohjen e pronësisës së ish-pronarit Gjokë Vako mbi këtë ndërtesë dhe kthimin e saj trashëgimtarëve ligjorë, paditësit kërkojnë konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit, kërkesë të cilën gjykata e rrethit e ka rrëzuar me arsyetimin se e paditura, duke qenë se gëzon të drejtën e pronësisë mbi ndërtesën, e ka ushtruar këtë të drejtë duke i kaluar një pjesë të pronësisë djalit të saj. Gjykata e apelit ka lënë në fuqi në tërësi vendimin e gjykatës së rrethit, pa analizuar kërkesën e konstatimit të pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit.

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, nga interpretimi në tërësi i dispozitave të sipërcituara, arrijnë në përfundimin se kontrata e dhurimit e lidhur ndërmjet të paditurve është e pavlefshme si rezultat i pavlefshmërisë së titullit të pronësisë të së paditurës Ollga Çomo, kjo në bazë të parimit *resoluto iure dantis resolvitur ius accipiendis*, në atë masë në të cilën anulohet e drejta e atij që jep, anulohet edhe e drejta e atij që merr.

Nga sa më sipër, duke qenë se e paditura Ollga Çomo gëzon cilësinë e trashëgimtares ligjore të Gjokë Vako së bashku me të tjerë trashëgimtarë ligjorë, ajo mund të disponojë vetëm pjesën e saj ideale që i takon nga kjo trashëgimi. Disponimi i të gjithë sendit, objekt i trashëgimisë ligjore, cenon të drejtat e trashëgimtarëve të tjerë ligjorë e, për rrjedhojë, zbatohet sanksioni i pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik në bazë të parimit *nemo dat quod non habet*, askush nuk mund t'i tjetërsojë tjetrit një të drejtë të cilën nuk e gëzon as vetë.

Edhe në këtë pjesë vendimet e gjykatave duhet të ndryshohen për shkak të pranimit të padisë për kthimin e banesës trashëgimtarëve ligjorë duke mos pranuar si pronare të vetme të paditurën Ollga Çomo.

**PËR KËTO ARSYE,**

Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 485/d të Kodit të Procedurës Civile

**VENDOSËN:**

Ndryshimin e vendimit nr.1802, datë 17.11.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe të vendimit nr.349, datë 15.11.2002 të Gjykatës së Apelit Korçë, si më poshtë:

Ndryshimin e vendimit nr.13, datë 29.10.1993 të Komisionit të Kthimit e të Kompensimit të Pronave ish-Pronarëve pranë bashkisë Pogradec, duke njohur pronësinë e ish-pronarit Gjokë Vako për një banesë dykatëshe me 16 dhoma, me oborr, 2 banja, 2 korridore, me sipërfaqe totale 312,6 m<sup>2</sup> kufizuar nga veriu - liqen, lindja - vëllezërit Vesho, perëndim - Nastasi Gusho, jugu - rrugë, dhe kthimin e saj trashëgimtarëve ligjorë të të ndjerit Gjokë Vako.

Konstatimin e pavlefshmërisë së kontratës së dhurimit nr.596 rep, nr.315 kol.datë 6.9.1994 lidhur midis të paditurve Ollga Çomo e Dhimitraq Çomo dhe të gjitha disponimeve të bëra më vonë.

Njësimin e praktikës ligjore, sikurse arsyetohet në këtë vendim.

Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare.

## MENDIMI I PAKICËS

Pakica është e mendimit se vendimi nr.349, datë 15.11.2002 i Gjykatës së Apelit Korçë është rrjedhojë e zbatimit dhe respektimit të kërkesave ligjore. Për pasojë, në përputhje me kërkesat e parashikuara në nenin 485/a të Kodit të Procedurës Civile, ai duhet të lihet në fuqi.

Është vërtetuar se i quajturi Gjokë Vako ka pasur në pronësi një godinë banimi të ndodhur në qytetin e Pogradecit, të përbërë nga dy kate në lagjen nr.1, rruga "Reshit Çollaku", me sipërfaqe prej 312,60 m<sup>2</sup>.

Kjo banesë, me vendimin nr.14, datë 22.2.1952 të ish-Komitetit Ekzekutiv të Këshillit Popullor të Rrethit dhe me pëlqimin e pronarit të saj, është shkëmbyer me godinën e ish- maternitetit të qytetit të Pogradecit, meqenëse kjo e fundit nuk kishte kapacitet dhe nuk plotësonte kërkesat për qëllimin që përdorej.

Godina në fjalë, ish-pronë e të quajturit Ali Erebara, ishte konfiskuar në favor të shtetit në vitin 1950.

Me aktin testamentar të datës 23 nëntor 1972, i quajturi Gjokë Vako disponon në favor të njëjës prej vajzave të tij, e konkretisht të së paditurës Ollga Çomo, banesën (ish-maternitetin) që kishte në pronësi të tij, duke përjashtuar vajzën tjetër, nënën e palës paditëse. Që nga kjo kohë dhe më pas, në këtë godinë ka banuar djali i Ollga Çomos, i padituri Dhimitraq Çomo.

Më pas, me miratimin e ligjit nr.7698, datë 15.4.1993 "Për kthimin e kompensimin e pronave ish-pronarëve", trashëgimtarët e Ali Erebarës kanë kërkuar pranë Komisionit të Kthimit e Kompensimit të Pronave, njohjen në pronësinë dhe kthimin e banesës së konfiskuar në vitin 1950, e cila, sikundër u përmend më lart, ishte këmbyer me banesën e Gjokë Vakos.

Komisioni i Kthimit e Kompensimit të Pronave vendosi ta njohë dhe ta kthejë këtë pronë në favor të tyre. Ndërkohë edhe e paditura Ollga Çomo, në cilësinë të trashëgimtares testamentare të Gjokë Vakos, i drejtohet Komisionit në fjalë dhe kërkon njohjen e kthimin të ish-pronës së babait të saj, e cila sikundër u tha ishte shkëmbyer në vitin 1952 me atë të Ali Erebarës.

Me vendimin nr.13, datë 29.10.1993 të KKK të Pronave pranë bashkisë Pogradec vendoset njohja e kthimi i kësaj prone në favor të Ollga Çomos. Më tej, e paditura Ollga Çomo, me kontratën datë 6.9.1994, këtë pronë ia ka dhuruar djalit të saj, Dhimitraq Çomo.

Pala paditëse, në cilësinë e trashëgimtarëve ligjorë të Gjokë Vakos, nga vajza tjetër e tij, kanë kërkuar me padi anulimin e vendimit të cituar të KKK të Pronave, si dhe anulimin e kontratës së sipërpërmendur të dhurimit. Paditësit, duke vënë në dyshim testamentin dhe mënyrën e përpilimit të tij, kanë pretenduar se në të bëhet fjalë për godinën e cila i është kthyer trashëgimtarëve të Ali Erebarës, dhe jo për godinën, njohur dhe kthyer me vendim të KKK të Pronave në favor të Ollga Çomos.

Në të kundërt, të paditurit kanë pretenduar se akti testamentar është vullneti i ligjshëm i trashëgimlënësit Gjokë Vako dhe është përpiluar në bazë e për zbatim të ligjit. Po ashtu, ata pretendojnë se me të drejtë Komisioni i KKK të Pronave ka disponuar në favor të trashëgimtarëve të Ali Erebarës për pronën e tyre të konfiskuar në vitin 1950 dhe në favor të Ollga Çomos për pronën e babait të saj të këmbyer në vitin 1952.

Pakica çmon se vendimet e të dyja gjykatave janë rrjedhojë e një vlerësimi të drejtë, objektiv dhe ligjor të të gjitha rrethanave të çështjes.

Në rastin konkret, me të drejtë arsyetohet në vendimet e të dyja gjykatave se vullneti i testatorit Gjokë Vako ka qenë për disponimin e një pjese të pasurisë së tij dhe konkretisht të banesës që ai ka pasur në pronësi, për kohën pas vdekjes në favor të Ollga Çomos. Në momentin e kryerjes së këtij veprimi juridik të njëanshëm, trashëgimlënësi Gjokë Vako ka shprehur vullnetin e tij të lirë për të disponuar, në favor të njëjës prej vajzave, **shtëpinë e vetme që ai kishte në pronësi**. Me fjalë të tjera, ai ka disponuar për një send të përcaktuar nga e gjithë pasuria e tij, send i cili ishte i vetëm për nga natyra e tij.

Fakti që më pas kjo banesë, si rrjedhojë e kërkesave të ligjit nr.7698, datë 15.4.1993, i është kthyer familjes Erebara dhe palës së paditur i është kthyer banesa e mëparshme, nuk do të thotë se në këtë rast kemi të bëjmë me një send, pronësia e të cilit, në momentin e përpilimit të aktit testamentar, nuk ishte fituar nga trashëgimlënësi. Pretendimi i palës paditëse se testamenti nuk mund t'i shtrijë efektet edhe mbi sende, të cilat janë fituar nga testatori pas hartimit të testamentit, pavarësisht se në parim është i drejtë, porë në raport me rastin konkret, nuk qëndron dhe nuk mund të qëndrojë. Efektivisht, kemi të bëjmë me të njëjtin send në vështrimin juridiko-civil dhe "dallimi" i sforcuar formal që kërkon apo, më e saktë, pretendon pala paditëse se duhet të bëhet, nisur nga karakteristikat fizike të sendit, çmohet se është i gabuar. Sikundër u tha edhe me lart, testatori ka pasur në pronësi një banesë dhe vetëm një dhe këtë banesë ai, me vullnet të lirë e ka disponuar në favor të njërit prej vajzave të tij. Trashëgimlënësi testamentar këtë send e ka pasur në pronësi në momentin e përpilimit të aktit testamentar dhe rregullimi që ligji i përmendur bëri për kthimin e pronave të pronarët e tyre, me saktë kalimin e banesave në fjalë të këta pronarë, nuk do të thotë se në vështrimin juridiko-civil kemi të bëjmë me një send tjetër të fituar në pronësi. Pra ky send është i përcaktuar në mënyrë individuale nga testamenti dhe nuk mund kurrsesi të trajtohet si pasuri e trashëgimlënësit në tërësi apo si një shtim i pasurisë pas hartimit të testamentit.

Efektivisht, kemi të bëjmë me të njëjtin send në pronësi.

Si konkluzion, pakica është e mendimit se trajtimi i kësaj çështjeje ligjore është e nevojshme të bëhet nga një këndvështrim realist, që mban në fokus pasojat e ardhura nga ndryshimi i regjimit juridik të pronës private gjatë periudhës së shtetit totalitar. Rregullimi i mundshëm i këtyre pasojave në periudhën post-komuniste lidhet me një proces të rregullt ligjor, që garanton respektimin e shprehjes së vullnetit të testatorit në kushtet e krijuara të asaj kohe.

Kështu, ajo që nuk ndryshon nga trajtimi teorik që i bën shumica aspekteve ligjore të kësaj çështjeje dhe që ka rëndësi vendimtare për zgjidhjen e saj është përgjigja e pyetjes: "Cili ka qenë vullneti i testatorit në kohën e lënies së testamentit?" Shprehje e këtij vullneti është *lënia e së vetmes shtëpi banimi* për të jetuar dhe disponuar njërit prej vajzave të tij. Kjo nënkupton se vetëm vajza e tij, si trashëgimtare me titull të posaçëm, përfiton sendin e lënë me testament, shtëpinë e banimit të vetme që kishte testatori dhe jo gjë tjetër.

Kuptimi i kësaj shprehjeje vullneti nga testatori nuk mund të ndryshojë me çeljen e trashëgimisë, pasi është i lidhur me të njëjtin destinacion të sendit dhe plotëson atë qëllim dhe vullnet që kishte ai në kohën e lëshimit të testamentit.

Kështu, në këtë rast nuk kemi të bëjmë me ndryshimin në thelb të pasurisë trashëgimore të konstatuar në kohën e çeljes së trashëgimisë.

Në analizë sa sipër, pakica është e mendimit se vendimi nr.13, datë 29.10.1993 i Komisionit të KK të Pronave është nxjerrë në përputhje me kërkesat ligjore. Për rrjedhojë edhe kontrata e dhurimit datë 6.9.1994 në favor të të paditurit Dhimitraq Çomo, është një veprim juridik tërësisht ligjor.

Përsa i përket shkaqeve të parashtruara në rekursin e paraqitur nga pala paditëse, mendimi i pakicës çmon se ato nuk qëndrojnë dhe nuk janë të tilla që të motivojnë apo përlligjin cenimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Korçë.

Për sa sipër, pakica në mbështetje të kërkesave të nenit 485/a të Kodit të Procedurës Civile, është për lënien në fuqi të vendimit nr.349, datë 15.11.2002 të Gjykatës së Apelit Korçë.

Anëtarë: Zamir Poda, Ylvi Myrtja, Besnik Imeraj, Perikli Zaharia, Spiro Spiro, Vladimir Metani

**VENDIM**  
**Nr. 53, datë 26.9.2005**

**PËR AFATIN E SHQYRTIMIT TË APLIKIMEVE PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE, NGA TË LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALET E VEGJËL**

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe nenit 22, germa g të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26, datë 13.5.2004 me ndryshimet përkatëse, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e datës 26.9.2005,

**VENDOSI:**

1. Paraqitja e kërkesës për miratim të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga prodhuesit e vegjël të energjisë elektrike, duke filluar nga viti 2006, të bëhet për 1 vit kalendarik, por jo më vonë se muaji shtator i çdo viti.
2. Në kuptim të këtij vendimi, do të përfshihen në kategorinë e centraleve të vegjël, centralet me një kapacitet deri në 5 MW, si dhe hidrocentrali i Smokthinës.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Pjetër Dema**

**VENDIM**  
**Nr. 359, datë 26.9.2005**

**PËR DHËNIE LICENCE**  
**PËR TELEVISIONIN KABLLOR PRIVAT**  
**“KL-ED”**

**SUBJEKTIT:SHOQËRIA “KL-ED KABËLL” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe rregullores “Për licencimin e operatorëve radiotelevizivë të transmetimeve me kabëll”, të miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**VENDOSI:**

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “KL-ED” sh.p.k., me vendndodhje në qytetin e Durrësit, licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv kabllor privat, në fushën e transmetimeve të televizionit me kabëll, për të penetruar në qytetin e Durrësit, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e penetrimit, kushtet teknike dhe tarifat.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Halil Lalaj**

**VENDIM**  
**Nr. 360, datë 26.9.2005**

**PËR DHËNIE LICENCE**  
**PËR RITRANSMETIM TË PROGRAMEVE TË HUAJA RADIO NË SHQIPËRISË**  
**“WORLD FAMILY”**

**SUBJEKTIT:SHOQËRIA “SCORPION” SHPK**

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të rregullores “Për licencimin e operatorëve për ritransmetimin e programeve të huaja televizive dhe radio me përsëritës”, miratuar me vendimin nr.26, datë 23.10.2000 të KKRT-së, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

**VENDOSI:**

1.T'i japë shoqërisë “Scorpion” sh.p.k., licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator për ritransmetimin e programit të huaj radio me përsëritës World Family, për të mbuluar me sinjal qytetet Tiranë, Shkodër dhe Elbasan.

2. Afati i licencës është 3 vjet nga data e hyrjes në fuqi të saj.

3. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zonat e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

4. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**  
**Halil Lalaj**

**KËRKESË**

Shtetësja Donika Karaj, kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, shtetasit Josif Karaj, lindur më 31.12.1937 dhe shpalljen e saj administrator të pasurisë së tij.

**KËRKUESE**  
**Donika Karaj**

**Fletorja Zyrtare gjendet:**

Duke u abonuar pranë:

- njërive postare të qyteteve;
- Qendrës së Publikimeve Zyrtare;
- në adresën:

Bulevardi Zhan d'Ark,  
pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"  
Tel: 042 555 63; 267 468

Përmbajtjen e Fletores Zyrtare mund ta konsultoni edhe në adresën e internetit:

[www.legjislacionishqiptar.gov.al](http://www.legjislacionishqiptar.gov.al) ose [www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**BOTIMET:**

1.	KUSHTETUTA (edhe anglisht)	600
2.	KODI I PROCEDURËS CIVILE	500
3.	KODI PENAL DHE KODI I PROCEDURËS PENALE (Botim,2005)	700
4.	KODI I PUNËS	500
5.	KODI I FAMILJES	450
6.	KODI CIVIL (Botim, 2005)	1000
7.	KODI RRUGOR DHE LIGJ PËR TRANSPORTIN	900
8.	KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)	355
9.	KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE (Botim,2005)	500
10.	DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR	1500

**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT	800
2.	PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK	1000
3.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim,2005)	600
4.	PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Botim,2005)	1500
5.	PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE	1500
1.	TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	1500
2.	TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004	2000

Doli nga shtypi më 14.10.2005

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare  
Tiranë, 2005

Çmimi: 100 lekë